



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKTLIGJ

Nr. _____/2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 35/2023 “PËR KOMPETENCAT PËR
CAKTIMIN E PAGAVE, TRAJTIMEVE TË TJERA FINANCIARE DHE
PËRFITIMEVE TË TË PUNËSUARVE NË INSTITUCIONET E ADMINISTRATËS
PUBLIKE, SI DHE TË PAGËS BAZË MINIMALE
NË SHKALLË VENDI”**

Në mbështetje të neneve 81, pika 1 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
VENDOSI:

Në ligjin nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, bëhet ndryshimi i mëposhtëm :

Neni 1

Në nenin 9, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë :

c) shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe të kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës mujore të kryetarit përkatës të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

Neni 2

Dsipozitë kalimtare

Shpërblimi për këshilltarët dhe kryetarët e fshatrave, t'i shtrije efektet e tij nga data e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 35/2023 “ Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare.

K R Y E T A R I

Lindita Nikolla

Miratuar në datën2023